- Koka e karriges të ketë mekanizëm të lëvizshëm dhe të lëvizë lart-poshtë, në të paktën 2 (dy) nivele dhe jastëku të jetë i me rrjete si mbështetësja.

Karrigja duhet të plotësojë kërkesat e standardit SSH EN 1335-1:2020+A1:2022; SSH EN 1335-2:2018 dhe SSH EN 12529:1998 (e njëvlefshme dhe e perditesuar)

21- A3/4 Kolltuk Tek

Kolltuk me strukture druri të veshur me një shtresë poliuretani me densitet të lartë, kembet të jenë të realizuara në metal në ngjyrën e inoksit të kromuar, në formë tubolare diam. 6cm me lartësi h10, të cilat duhet të mbështeten në strukturen e drurit, krahë dhe shpinorja duhet të jenë në të njëjten lartësi H 65, krahët duhet të kenë një bazament dhe dimension L 14.5cm duhet të përfundojnë me zvoglim nga pjesa e brendshme,

Krahët duhet të jenë lehtësisht të harkuar për të realizuar një ulje dhe qëndrim komod, mbushja e brendshme dhe jastekët e uljes dhe krahët duhet të jenë realizuar në poliuretan ekologjik me densitet të diferencuar, të veshur me një cope pambuk antialergjik, veshja e realizuar në lekure ekologjike. Jastekët e uljes të jenë të levizshëm, ndërsa struktura e shpines dhe krahët të jenë të fiksuar.

Kolltuku duhet të plotësojë kërkesat e standardit SSH EN 13759 :2012 (e njëvlefshme dhe e perditesuar)


23- A3/5 Kolltuk dopjo për ndenje.

Kolltuk me strukture druri të veshur me një shtresë poliuretani me densitet të lartë, kembet të jenë të realizuara në metal në ngjyrën e inoksit të kromuar, në formë tubolare diam. 6cm me lartësi h10, të cilat duhet të mbështeten në strukturen e drurit, krahë dhe shpinorja duhet të jenë në të njëjten lartësi H 65, krahët duhet të kenë një bazament dhe dimension L 14.5cm, duhet të përfundojnë me zvoglim nga pjesa e brendshme.

Krahët duhet të jenë lehtësisht të harkuar për të realizuar një ulje dhe qëndrim komod, mbushja e brendshme, jastekët e uljes dhe krahët duhet të jenë realizuar në poliuretan ekologjik me densitet të diferencuar, të veshur me një cope pambuk antialergjik, veshja e realizuar në lekure ekologjike, jastekët e uljes të jenë të levizshëm, ndërsa struktura e shpines dhe krahët të jenë të fiksuar.

24- A3/6 Stola tresh për klientet e KNK

Stola me përberje alumini/celiku me punim rrjete në shpinore. Kembet e stolit janë të realizuara me kembe metalike të gomuara.



25- A4 Reception module

DIMENSIONET: L_155x80x120cm

Receptioni duhet të realizohet prej materiali lëndë drusore MDF me lysterje me bojë akrilike ose poliuretani.

Trashësia e syprinës do të realizohet me spesor 25 mm me material mdf e lyster me disa shtresa, e cila do të krijoj një sipërfaqe të fortë kundër gervishjeve, dhe të jetë lehtësisht e pastrueshme.

Kembet e tavolines duhet të realizohen me material mdf me lysterje me spesor 25mm.

Pjesa ballore e tavolines do të mbyllet po me të njëjtin material me mdf me lysterje me spesor 25mm


Në pjesën fundore kembet duhet të jenë të pajisura me tapa niveluese. Në pjesën e sipërme do hapen dy vrima në anesoret e syprinës së tavolines për kalimin e kabllave të ekranit dhe tastierës. Këto vrima do mbyllën me kapak plastik me ngjyrë të bardhë opake.

Në pjesën eposhtmetes syprinës do vendosen kanalina plastike për sistemin e kabllave.

Receptioni do të kenë edhe një pjesë ballore të ngritur prej të njëjtit material dhe me të njëjten ngjyrë sipërfaqe operatorit. Në pjesët anësore të tavolines do të vendosen xhamat opak të cilët do të jenë të temperuar me kapje anësore në strukturën metalike me lartësi 30 cm në pjesën e sipërme të syprinës së punës.

Ngjyra e preferuar e syprinës: Do të përzgjidhet nga porositësi me katalog.

Dizajni i preferuar: si në skicë ose dizajn i ngjashëm.



26- A5 Sirtarier me rrota

DIMENSIONET: L_35x44x58cm

Sirtariera duhet të realizohet prej materiali lëndë drusore MDF me lysterje me bojë akrilike ose poliuretani.

Trashësia e syprinës do të realizohet me spesor 25 mm me material mdf e lyster me disa shtresa, e cila do të krijoj një sipërfaqe të fortë kundër gervishjeve, dhe të jetë lehtësisht e pastrueshme.


Sirtaret duhet të realizohen me spesor 18 mm me paterial mdf me lysterje rezistente kundër gervishtjeve. Sirtariera duhet të paiset me celes qendror dhe 4 rrota.

Guidat rreshqitëse të jenë metalike me rroteza nyroni. Me fund korse në hapje dhe vetmbyllje. Kabineti i sirtarëve do të jetë me tre sirtarë, sipas kërkesave të porositësit. Në çdo rast kabineti do të jetë i pajisur me çelës.

Ngjyra e preferuar e: Do të përzgjidhet nga porositësi me katalog.

Dizajni i preferuar: si në skicë ose dizajn i ngjashëm.

Komedina duhet të plotësojë kërkesat e standardit SSH EN 15338:2007+A1:2010 (e njëvlefshme dhe e përditësuar)




27 - A6 Vareserrobash + Mbajtese cadrash

Struktura duhet te kete 8 vende per te varrur rrobat dhe nje vend bashkangjitur per cadrat, bazamenti duhet te jete I rend dhe solid.

Montimi dhe zmontimi duhet te jete sa me I thjeshte dhe I lehte per tu levizur.

28- A7 - Mbajtesepernjeseqendrore



DIMENSIONET: L_23.2xh12x53.2cm

Strukturatejeteerealizuar me material mdf e lyer me spesor 18 e cila do te krijoj nje siperfaqe te forte kunder gervishjeve, dhe te jete lehtesisht e pastrueshme.

Mobiljatejeteendertuar ne pjesen e poshtme me rrotaplastike per te bere te mundur levizjen e njese qendrore .

29- A8 Kasaforte sekrete

Permasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 50x50x110 cm

Karakteristikat kryesore të produktit do të jenë: Kasaforta duhet të ketë strukturë llamarinë me trashësi jo më pak se 1.5 mm. Të ketë dy ndarje horizontale nga brenda, ku të krijohen tre hapësira. Dera të jetë e pajisur me dorezë dhe bravë automatike sekrete. Lyerja me mënyrë elektrostetike. Bazamenti të jetë jo më pak se 10 cm.

Kasaforta të ketë paraqitje estetike dhe saldimet të mos shikohen në pjesën e jashtme. Të paketohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

30- A9 Skeleri metalike për arkive

Skeleria (raftet) duhet të jenë prodhime cilësore dhe solide.

Skeleria metalike të jenë sisteme modulare të përmasave të ndryshme, çka i bën ato të përshtatshme sa më mirë dhe pa humbje hapësire çdo ambienti e nevojë. Pjesët përbërëse të skelerisë duhet të jenë: Kolonat, Sergjenet, Lidhëset e kolonave, Tapat për kolonat, Aksesorë të ndryshëm fiksues në vartësi të vendit dhe mënyrës së vendosjes. Kolonat të jenë prej metali cilësi e parë, me spesor jo më të vogël se 1.2 mm dhe të zingëruara. Kolonat të jenë me dallgëzime të studiuar, në mënyrë që të mbajnë pesha të rënda dhe me fole në çdo 5 cm afërsisht, Sergjenet të jenë prej llamarine me trashësi min (spesor) 0.8-1mm. Përmasat e sergjeneve të jenë 100 x 40 cm. Peshëmbajtja e një sergjieni të jetë 200 kg (peshë) e shpërndarë. Skeleria metalike të jenë krijuar, në mënyrë që të lidhen linearisht me njëri-tjetrin. Skeleria duhet të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004

31- A10 Perde Role

Faktori i hapjes ndaj dritës: 5%.

Përbërja: 70% PVC; 30% Poliestër.

Pesha: 550 g/m².

Trashësia e copës: 0.58 mm.

Tejdukshmëria: 1%.

Bllokimi i rrezeve ultra violet (UV): rreth 99%.

Shpejtësia ndaj dritës: 8.

Zjarrdurues: Po, klasa 1(parë).

Orientimi : I dyanshëm.

Mënyra e pastrimit: Me copë të lagur të shtrydhur.

Elementë të tjerë shtesë: Ngjyra e grilave do të caktohet nga AK në bazë të modeleve që do të paraqiten nga OE. Grilat duhet të kenë aksesor montimi metalik, grup komandimi, kapakë, zinxhir komandimi.

32- A11 Dollap metalik me dyer hapje forme flamur

Dollap metalik duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyer që të rezistojë korrozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbijllje me çelës. Dyert janë me hapje në formë flamuri. Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenet ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.

Dimensionet duhet të jenë min 90x40x180

Dollapet duhet të plotësojë kërkesat e Standartit CEN/TR 14073-1:2004, EN 14073-2:2004, EN 14073-3:2004, EN 14074:2004

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Kodi	Tipi	Emertimi	Njesia	FSHU	OSSH	FTL	OSHEE Group	Sasia Totale
1	A1	F-V	Modul per tavoline pune modulare	cope	350	220	20	20	610
5	A1/1	F-V	Tavoline pune personale	cope	50	50	10	10	120
6	A1/2	F-V	Tavoline pune personale FSHU	cope	70	0	0	0	70
7	A1/3	F-V	Tavoline pune arke FSHU	cope	70	0	0	0	70
8	A1/4	F-V	Tavoline pune rangu Drejtues	cope	5	3	2	10	20
9	A1/5	F-V	Tavoline Mbledhje Modulare	cope	1	1	0	1	3
10	A1/6	F-V	Tavoline Mbledhje Drejtkendore	cope	1	1	0	1	3
11	A1/7	F-V	Tavoline Mbledhje Rrethore	cope	1	1	1	2	5
12	A1/8	F-V	Tavoline Mbledhje	cope	1	1	0	1	3
13	A2	F-V	Raft Zyre 90x75x210	cope	10	10	3	7	30
14	A2/1	F-V	Raft Zyre 125x45x210	cope	10	10	3	7	30
15	A2/2	F-V	Raft per mbajtej n e sendeve	cope	10	10	3	7	30
16	A2/3	F-V	Raft anesor per tavoline	cope	10	10	3	7	30
17	A2/4	F-V	Raft pa mbyllje ballore	cope	15	10	10	15	50
18	A2/5	F-V	Raft me mbyllje ballore	cope	15	10	10	15	50
19	A2/6	F-V	Raft 90x190x45	cope	15	10	10	15	50
20	A2/7	F-V	Raft Arkive	cope	20	10	0	0	30
21	A3	F-V	Karrige Statike Sherbim Klienti	cope	50	20	0	0	70
22	A3/1	F-V	Karrige Statike Tavoline Mbledhje	cope	10	5	0	5	20
23	A3/2	F-V	Karrige Rangu Drejtues	cope	4	4	2	10	20
24	A3/3	F-V	Karrige me rrota per personelin	cope	250	200	50	100	600
25	A3/4	F-V	Kolltuk tek	cope	7	6	2	5	20
26	A3/5	F-V	Kolltuk dopio	cope	3	5	1	1	10
27	A3/6	F-V	Stola tresh per klientet e KNK	cope	40	7	0	3	50
28	A4	F-V	Recepsion me module	cope	1	2	0	0	3
29	A5	F-V	Sirtarier me rrota	cope	50	10	10	10	80
30	A6	F-V	Varese rrobash + mbajttese cadrash	cope	30	10	5	5	50
31	A7	F-V	Majttese per njesite qendrore	cope	50	10	10	10	80
32	A8	F-V	Kasaforta sekrete	cope	24	5	1	0	30
33	A9	F-V	Skeleri metalike per arkive	cope	50	50	10	40	150
34	A10	F-V	Perde role	m2	0	150	50	90	290

35	A11	F-V	Dollape metalike	cope	30	30	10	10	80
----	-----	-----	------------------	------	----	----	----	----	----

Afati i lëvrim: është 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes së porosisë.

Sqarim: Sasitë e mesiperme janë në nivel parashikimi, ndaj gjatë zbatimit të marrëveshjes kuader shoqëritë përfituese kanë të drejtën të ruajnë keto sasi të parashikuara ose ti ndryshojnë ato në varësi të nevojave konkrete, por pa tejkaluar vlerën totale të shpallur përfituese. Ndryshimet e sasive do të përballohen financiarisht nga vete shoqëritë përfituese, pavarësisht parashikimeve fillestare.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore” të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, sipas kështjave të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare dhe të paraqesë:

- a) ISO 9001:2015 ose ekuivalente, "Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise" (e vlefshme);
- b) ISO 14001:2015 ose ekuivalente perfshire Leje Mjedisore, „Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit“ (e vlefshme);
- c) ISO 45001:2018/ ISO 45001-**2023** (të përditësuar)ose ekuivalente, "Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune" (e vlefshme);
- d) UNI EN ISO 3834-2:2006 ose ekuivalente , "Kerkesat e cilesise per saldimin e materialeve metalike" (e vlefshme);

Qellimi i certifikimit te kompanise duhet te jete sipas fushes se objektit qe do te prokurohet.

Çertifikatat te jene leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certefikata ISO sipas zerave te puneve/mallrave/sherbimeve qe do te marr persiper te realizoj sipas akt-marreveshjes paraprake.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues kur eshte i profilit prodhues duhet të ketë të punësuar të paktën 30 (tridhjetë) punonjës, kur eshte i profilit tregetues (kur eshte tregetues i mbi 50 % te numenklatures se artikujve te kerkuar) jo me pak se 22 punonjes të cilët duhet të figurojnë në listpagesën e shoqërisë të paktën muajine fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kriteri 2.3.3 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 9. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.4Operatori ekonomik sipas natyres se tij **prodhues apo tregetues** (operator prodhues konsiderohen ato operator qe nepermjet procesit te prodhimit transfromojne lendet e para dhe ndihmese ne produkte te gatshme apo montojne pjese te produktit te prodhuara nga subjekte te tjere duke i transformuar ne produkte te gatshem. Operator tregetues jane ato operator qe marrin pjese ne blerje-shitje te produkteve te gatshme pa marre pjese ne prodhim) duhet te kete minimalisht te punesuar punonjes sipas profesioneve **me kode respektive apo te peraferta sipas listes se profesioneve si ne ne table:**

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve	Kodi orientues korespondues i profesionit ose kode te peraferta profesionesh sipas VKM nr. 514, date 20.9.2017
1	Inxhinier druri (prodhues/perpunues)	1	2141.01
2	Arkitekt (prodhues/perpunues dhe operatoret tregetues)	1	2161.04
3	Shofer (prodhues/perpunues dhe operatoret	3	8322.01

	tregetues)		
4	Punonjes te certifikuar/kualifikuar Marangoz per operatoret (prodhues/perpunues)	3	7115.14
5	Punonjes te certifikuar/kualifikuar Montues per subjektet (prodhues/perpunues dhe operatoret tregetues)	2	8215.02
6	Punonjes te certifikuar/kualifikuar Saldator (prodhues/perpunues)	3	7212.09
7	Punetor krah/ngarkim shkarkimi/ndihmes (prodhues/perpunues dhe operatoret tregetues)	5	9622.01

Per profilet e punonjeseve te kerkuar si me siper, Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike duhet te deklaroje ne formularin e vetedeklarimit shtojca 9, Emer, mbiemer punonjesi dhe i pari i kualifikuar duhet te paraqes per secilin punonjes te deklaruar:

- Per punonjesin me profesion Inxhinier Druri dhe Arkitekt, operatori Ekonomik duhet te dorezoje Kontraten e punes, Diplomen e arsimit te Larte dhe CV.
- Kontratat e punes per cdo punonjes tjeter te listuar, ku punemarresi dhe punedhenesi kane rene dakord qe nga punemarresi te punohet ne profesionin e kerkuar si ne tabele.
- Leje drejtimi automjeti per punonjesit me profesion shofer apo qe do te mbulojne kete funksion per zbatimin e kontrates.
- Certificate/Deshmi aftesimi/kualifikimi/trajnimi ne profesionin respektiv te kerkuar per profesionet Marangoz, Montues, Saldator per punonjesit qe do te mbulojne keto profesione per realizimin e kontrates

Punonjesit e deklaruar si me siper duhet te figurojne ne listpagesen e fundit te deklaruar sipas kerkesave ligjore.

Punonjesit e kerkuar me profesion Inxhinier Druri dhe Arkitekt duhet qe detyrimisht te figurojne ne listpagesen e deklaruar, ne kodin e profesionit qe percakton VKM nr. 514, date 20.9.2017 "Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), te rishikuar" per profesionet e tyre.

Shenim: Kriteri 2.3.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 9. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesemarres/bashkimi i operatoreve duhet te kene ne stafin e tij personel te kualifikuar/certifikuar si:

-1 (nje) punonjes te disponoje certificate si "*Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune*" ne perputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per

sigurine dhe shendetin ne pune”, e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Shenim: Ky kriter do te konsiderohet i permbushur nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas Shtojces 9 te DST. Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane autoritetit kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe nisjes se afateve te ankimit, ose nese do te jete nevoja per t’u kerkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te disponoje minimum **2 (dy) mjete transporti me peshe mbajtese mbi 1.5 ton** te pershtatshem per transport mallrash. Mjeti i transportit mund te jene ne pronesi ose me qira/huaperdorje.

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruara me qera/huaperdorje, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/huaperdorjes.

Shenim: Ky kriter do te konsiderohet i permbushur nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas Shtojces 9 te DST. Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane autoritetit kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe nisjes se afateve te ankimit, ose nese do te jete nevoja per t’u kerkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.7 Operatori ekonomik/Bashkimi i operatoreve ekonomike sipas artikujve qe marrin persiper per furnizim, per artikujt e kerkuar si me poshte duhet te paraqese dokumentacion baze “*Certifikate/Certifikate testimi*” per produktitet:

- **Karrige zyre rrotulluese**, produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020/A1:2022 (Mobilje zyre - Karrige pune per zyra - Pjesa 1: Dimensionet); SSH EN 1335-2:2018 (Mobilje per zyra - Karrige per zyre - Pjesa 2: Kerkesat e sigurise); SSH EN 16139:2013/AC:2013 (Mobilje - Qendrueshmeria,fortesia dhe siguria - Kerkesat per ndenjeset jo – shtepiake); e njevlefshme ose e perditesuar

- **Sirtariere (Komedine)** produkt i certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 15338:2007+A1:2010 (Aksesoret metalik per mobiljet - Fortesia dhe jetegjatesia e elementeve dhe komponenteve te tyre gjate terheqjes) e njevlefshme ose e perditesuar

- **Kolltuk produkt i certifikuar** ne perputhje me standardin SSH EN 1728:2012 (Mobilje Ndenjeset - Metodat e provave per percaktimin e fortesise dhe qendrueshmerise); SSH EN 12520:2015 (Mobilje - Fortesia, jetegjatesia dhe siguria); SSH EN 1022:2018 (Percaktimi i qendrueshmerise) e njevlefshme ose e perditesuar

Si dokument alternativ ne vend te “Certifikate/Certifikate testimi” te produkteve koresponduese e standardeve te mesiperme, operatori ekonomik mund te paraqese Certifikata me reference standarde ekuivalente (Certifikata ekuivalente konsiderohet certifikate qe nuk i referohet sistemit europian EN te standardeve, por nje sistemi tjetër standardesh por qe trajton te njejtet tregues dhe norma te testuara dhe konfirmuara te produktit si ne sistemin EN)/te “Perditesuara” sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe te leshuara nga Organizma te Vleresimit te Konformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise ose Organizma Nderkombetare akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise, si dhe dokumenta te tjere alternative si “Certifikate/Deklarate Konformiteti”, “Deklarate CE” “Skeda Teknike”, “Pasaporta Teknologjike” me kusht qe keta dokumenta alternative te jene te shoqeruara me “Raportet e Testimit” per secilin produkt me reference standarde e kerkuara si me siper.

Çertifikatat e kerkuara duhet te jene te vlefshme per gjate periudhes se realizimit te procedures se prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet te jene origjinale ose te njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e mesiperme duhet te jenete leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatorët duhet te disponojne dokumentacionin e kerkuar ne perputhje me raportin e pjesemarrjes ne furnizim, te percaktuara ne akt marreveshje.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te deklaroje sipas tabelës 1 nese eshte prodhues ose sipas tabelës 2 nese eshte **tregtues i autorizuar** nga prodhuesi ose **distributor i autorizuar nga prodhues** per mallrat objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si prodhues/perpunues i mallit.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit
1		
2		
Etj.,		

Tabela 2. Forma e deklarimit per operatorin ekonomik qe paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi/perpunuesi.

Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjines se mallit	Prodhuesi/ Distributori i autorizuar nga prodhuesi/perpunuesi
1			
2			
Etj.,			

2.3.9 Per mallrat objekt prokurimi qe perfshihen ne tabelen 2, OE duhet te paraqese "Autorizim Prodhuesi/Autorizim Distributori/Konrate furnizimi". Dokumentei duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjitha artikujve ne adresat e percaktuara ne planin e shperndarjes. Per ngjyrat e mobiljeve, duhet te kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate per periudhen e garancise se artikujve (jo me pak se 1 vit nga data e dorezimit te artikujve), gjate se ciles ofertuesi do te siguroje riparimin dhe mirembajtjen e tyre, per paisjet qe kane defekte nga prodhimi.

2.3.12 Operatori ekonomik per artikujt e poshteshenuar:

- Karrige me rrota per personelin
- Tavoline pune personale te FSHU
- Tavoline pune arke
- Tavoline pune rang drejtuesi
- Tavoline pune 90x60x210 cm
- Raft per mbajtjen e sendeve
- Karrige statike per mbledhje

Diten dhe oren e hapjes se procedures, duhet të paraqesë nga një mostër të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara ne shtojcë "Specifikimet Teknike" të DST-së.

Per cdo artikull "moster" te dorezuar, duhet qe te jete bashkelidhur me mostren etiketa e firmosur dhe vulosur me treguesit kryesore te kompanise dhe procedures.

2.3.13. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

- I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----

E-mail:	----- ---
---------	--------------

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

⁶Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratënëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

